



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 577/1 prot.

Tiranë, më 05.03.2026

VENDIM

Nr. 10, datë 05.03.2026

PËR

RRËZIMIN E ANKESËS

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Znj. (në vijim “ankuesja”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesën nr. 577 Prot., datë 23.02.2026, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Shoqërisë “Integrated Energy BV SPV” Sh.p.k.

Ankuesja, nëpërmjet kërkesës datë 21.01.2026, depozituar në adresën elektronike anil@integritenergy.com, ka kërkuar nga Shoqëria “Integrated Energy BV SPV” Sh.P.K., t’i vihet në dispozicion informacioni, në lidhje me depozitimin e inerteve në zonën e Sharrës, për 3 vitet e fundit, konkretisht:

1. Sa është volumi i depozitimit të inerteve për secilin nga 3 vitet e fundit (shprehur në metër kub ose ton)?
2. Sa janë të ardhurat totale të arkëtuara nga depozitimi i inerteve për secilin vit?
3. A ka hapësira të lira për depozitimin e inerteve aktualisht apo jo? Nëse, po sasinë e mbetur të kapaciteti; Nëse jo, arsyen.

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, pasi Shoqëria “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k., nuk ka kthyer përgjigje lidhur me kërkesën për informacion, ankuesja ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit, duke kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe bazës ligjore të saj, në përputhje me pikën 3, të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”), pikës 2 të nenit 44 të Kodit të Procedurave Administrative sipas të cilit “*Organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën lidhur me përmbushjen e kriteve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi...*”, si dhe gërmës “b” të nenit 65 të Kodit të Procedurave Administrative, i cili parashikon se: “*Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme...b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative*”, ka verifikuar statusin juridik të subjektit ndaj të cilit kërkohet fillimi i procedurës administrative, Shoqërisë “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k.

Nga verifikimi i kryer në Qendrën Kombëtare të Biznesit rezulton se, Shoqëria “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k., është shoqëri tregtare e regjistruar në Regjistrin Tregtar me numër unik të identifikimit të subjektit L72031013B. Referuar ekstraktit të Regjistrit Tregtar për të dhënat e subjektit, rezulton se “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me 100% aksione private. Ndërkohë, objekti i LDI, është garantimi i njohjes së publikut me *informacion/dokumentacion publik*, që prodhohet ose mbahet nga ana e autoriteteve publike.

Në kuptim të nenit 2, pika 1 e LDI “*Autoritet publik*”: a) është çdo organ publik, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative*”, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj; b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës “c” të kësaj pike; c) çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.

Për sa më sipër parashtruar, rezulton se Shoqëria “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k., nuk është autoritet publik në kuptim të LDI. Për rrjedhojë, për shkak të mungesës së legjitimitimit të palës në këtë procedurë administrative, si subjekt i LDI, ankesa e paraqitur nuk i nënshtrohet dispozitave të këtij ligji, për të vijuar më tej procedurat për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c), të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankesës nr. 577 Prot., datë 23.02.2026, të znj. _____, kundër Shoqërisë “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k., me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.

2. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
3. Ky vendim u shpall sot në datë 05.03.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi